



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E FINANCAVE/MINISTARSTVO ZA FINANSIJE
MINISTRY OF FINANCE

KB FR Kosovo Board on Standards for Financial Reporting
 BK RF Bordi Kosovar mbi Standardet per Raportim Financiar
 KB FI Kosovski Bord za Standarde Finansijskog Izvestavanja

SKK 19

Fitimet për aksion

Qëllimi

Qëllimi i këtij standardi është që t'i përshkruajë parimet për përcaktimin dhe paraqitjen e fitimeve për aksion që do t'i përmirësojë krahasimet kualitative ndërmjet ndërmarrjeve të ndryshme për të njëjtën periudhë dhe ndërmjet periudhave të ndryshme përlogaritëse për të njëjtën ndërmarrje.

Fushëveprimi

1. Ky standard duhet të aplikohet nga ndërmarrjet, aksionet e zakonshme ose aksionet e zakonshme potenciale të cilave tregtohen publikisht dhe nga ndërmarrjet që janë në proces të emetimit të aksioneve të zakonshme ose aksioneve të zakonshme potenciale në tregjet publike të letrave me vlerë.
2. Ndërmarrja që nuk ka as aksione të zakonshme e as aksione të zakonshme potenciale që tregëtohen publikisht por që i shpalosë fitimet për aksion, duhet t'i llogarisë dhe t'i shpalosë fitimet për aksion konform me këtë standard.

3. Ndërmarrja që nuk ka as aksione të zakonshme e as aksione të zakonshme potenciale që tregtohen publikisht, nuk kërkohet që t'i shpalosë fitimet për aksion. Megjithatë, krahasueshmëria në raporte financiare ndërmjet ndërmarrjeve ruhet, nëse ndonjë ndërmarrje e tillë zgjedh për t'i shpalosur fitimet për aksion konform me parimet e këtij standardi.

Përkufizimet

4. Shprehjet vijuese përdoren në këtë standard me këto kuptime të caktuara:

aksioni i zakonshëm është një instrument i ekuitetit që është varet për të gjitha llojet e tjera të instrumenteve të ekuitetit.

aksioni i zakonshëm potencial është një instrument financiar ose kontratë tjetër që mund t'i japë të drejtë mbajtësit të tij për aksione të zakonshme.

aksioni i preferuar (me përparësi) është një instrument ekuiteti që i jep mbajtësit të tij përparësi në pranimin e dividendit nga ndërmarrja. Sa i përket dividendit, aksioni i preferuar mund të jetë jokumulativ ose kumulativ.

aksionet e preferuara **jokumulative** janë ato që nuk kanë të drejtë ta marrin dividendin, përderisa dividendët të mos shpallen nga ndërmarrja.

aksionet e preferuara **kumulative** janë ato që e mbajnë të drejtën për të marrë dividend pa marrë parasysh nëse janë shpallur nga ndërmarrja. Normalisht caktohet shuma e dividendit. Nëse dividendë nuk shpallen, mbajtësit e aksioneve të preferuara kumulative nuk marrin pagesë të dividendit, megjithatë e drejta për të marrë dividend bartet në të ardhmen derisa të shpallen dividendët nga ndërmarrja.

5. aksionet e zakonshme marrin pjesë në fitimin neto për periudhën vetëm pas llojeve të tjera të aksioneve, siç janë aksionet e preferuara.
6. Shembuj të aksioneve të zakonshme potenciale janë:
 - (a) Instrumentet e borxhit ose të ekuitetit, përfshirë aksionet e preferuara që janë të këmbyeshme në aksione të zakonshme; dhe
 - (b) Planet e punëtorëve që u lejojnë atyre t'i marrin aksionet e zakonshme si pjesë e pagesës së tyre dhe planet tjera të blerjes së aksionit.

7. Shprehjet vijuese përdoren me këto kuptime të caktuara në SKK 14 “Instrumentet Financiare”:

Instrument financiar është çdo kontratë që u jep rritje edhe pasurisë financiare të një ndërmarrje, edhe obligimit financiar ose instrument ekuiteti i ndërmarrjes tjetër.

Instrument ekuiteti është çdo kontratë që e evidencon interesin e mbetur në pasuritë e një ndërmarrjeje pas zbritjes së të gjitha obligimeve të saj.

Vlera fer është shuma për të cilën pasuria mund të këmbëhet ose obligimi të paguhet, midis të mirë informuarve, palëve të gatshme në transaksionin duarlibër.

Transaksioni duarlibër është transaksioni midis palëve të palidhura, që veprojnë secila në interesin e vet personal.

Matja

8. Fitimet bazë për aksion duhet të llogariten duke e ndarë fitimin ose humbjen neto për periudhën e atribueshme për aksionarët e zakonshëm nga numri mesatar i ponderuar i aksioneve të zakonshme të mbetura gjatë periudhës.
9. Me qëllim të llogaritjes së fitimeve për aksion, fitimi ose humbja neto për periudhën e atribueshme për aksionarët e zakonshëm duhet të jetë fitimi ose humbja neto për periudhë pas zbritjes së dividendave të preferuara.
10. Të gjithë zërat e së ardhurës dhe të shpenzimit që njihen në periudhë përfshirë shpenzimin e tatimit dhe zërat e jashtëzakonshëm, përfshihen në përcaktimin e fitimit ose humbjes neto për periudhën (shih SKK 5 “Fitimi ose humbja neto për periudhën, zërat e jashtëzakonshëm, ndryshimet në vlerësimet e kontabilitetit, ndryshimet në politikat kontabiliste dhe gabimet fundamentale”). Shuma e dividendave të preferuar për periudhën zbritet nga fitimi neto për periudhën (ose shtohet për humbjen neto për periudhën) në mënyrë që të llogaritet fitimi ose humbja neto për periudhën që u atribuohet aksionarëve të zakonshëm.
11. Shuma e dividendave të preferuar që zbritet nga fitimi neto për periudhën është:
- shuma e çdo dividendi preferues mbi aksionet preferuese jokumulative të shpallura në lidhje me periudhën; dhe
 - shuma e plotë e dividendave të preferuar të kërkuar për aksionet preferuese kumulative për periudhën, pa marrë parasysh se a

është shpallur dividendi. Shuma e dividendëve të preferuara për periudhën nuk përfshin shumën e ndonjë dividendi preferues për aksionet preferuese kumulative të paguara ose të shpallura gjatë periudhës vijuese në lidhje me periudhat paraprake.

12. Me qëllim të llogaritjes së fitimeve bazë për aksion, numri i aksioneve të zakonshme duhet të jetë numri mesatar i ponderuar i aksioneve të zakonshme të mbetura gjatë periudhës.
13. Numri mesatar i ponderuar i aksioneve të zakonshme të mbetura gjatë periudhës pasqyron faktin se shumta e kapitalit të aksionarëve mund të ndryshojë gjatë periudhës si rezultat i numrit më të madh ose më të vogël të aksioneve që kanë mbetur në çdo kohë. Ky është numri i aksioneve të zakonshme të mbetura në fillim të periudhës, i harmonizuar me numrin e aksioneve të zakonshme të riblera ose të emetuara gjatë periudhës, shumëzuar me faktorin kohë të ponderuar. Faktori kohë i ponderuar është numri i ditëve që aksionet specifike kanë mbetur si përpjestim i numrit total të ditëve për periudhë.

Shembull Numri mesatar i ponderuar i aksioneve		aksionet e emetuara	aksionet e mbetura
1 janar 2002	Gjendja në fillim të vitit	2,000	2,000
31 maj 2002	Emetimi i aksioneve të reja për para të gatshme	800	2,800
31 dhjetor 2002	Gjendja në fund të vitit	2,800	2,800

Logaritja e numrit mesatar të ponderuar të aksioneve:
 $(2,000 \times 5/12) + (2,800 \times 7/12) = 2,467$ -or-
 $(2,000 \times 12/12) + (800 \times 7/12) = 2,467$

14. Në shumicën e rasteve, aksionet përfshihen në numrin mesatar të ponderuar të aksioneve nga data kur konsiderata bëhet e arkëtueshme (që zakonisht është data e emetimit të tyre), për shembull:
 - (a) aksionet e zakonshme të emetuara në këmbim për para të gatshme përfshihen, kur të merren ato;
 - (b) aksionet e zakonshme të emetuara në këmbim për kryerjen e obligimit të ndërmarrjes përfshihen në datën e kryerjes;

- (c) aksionet e zakonshme të emetuara në fakt për përvetësimin e pasurisë së ndryshme nga paraja e gatshme përfshihen në datën, kur njihet përvetësimi; dhe
- (d) aksionet e zakonshme të emetuara për pagimin e shërbimeve të ndërmarrjes përfshihen ashtu si paguhen shërbimet.

Në këto dhe në raste të tjera koha e përfshirjes së aksioneve të zakonshme përcaktohet nga afatet dhe kushtet që përmbanë çështja e tyre. Konsideratë e duhur duhet t'i jepet substancës së çdo kontrate të lidhur me çështjen.

15. Kur aksionet e zakonshme emetohen në formë të paguar pjesërisht, këto aksione të paguara pjesërisht trajtohen si pjesë e aksionit të zakonshëm deri në nivelin në të cilin ato kanë të drejtë të marrin pjesë në dividende në krahasim me aksionin e zakonshëm të paguar tërësisht gjatë periudhës financiare.
16. Numri mesatar i ponderuar i aksioneve të mbetura gjatë periudhës dhe për të gjitha periudhat e paraqitura duhet të harmonizohet për ngjarjet, ndryshe nga përndrymi i aksioneve të zakonshme potenciale që e kanë ndërruar numrin e aksioneve të zakonshme të mbetura, pa ndryshim korrespondues në burime.
17. Aksionet e zakonshme mund të emetohen ose numri i aksioneve të mbetura mund të zvogëlohet, pa ndryshimin korrespondues të burimeve. Një shembull i tillë është kapitalizimi ose çështja e shpërblimit (po ashtu e njohur si dividend i aksionit).
18. Në çështjen e kapitalizimit ose shpërblimit ose ndarjes së aksionit, aksionet e zakonshme u emetohen aksionarëve ekzistues për konsideratë shtesë. Prandaj, numri i aksioneve të zakonshme të mbetura rritet pa rritje të burimeve. Numri i aksioneve para se ngjarja të harmonizohet për ndryshimin proporcional në numrin e aksioneve të zakonshme të mbetura sikur ngjarja të ndodhte në fillim të periudhës më të hershme të raportuar. Për shembull, nga dy-për-një çështje të shpërblimit, numri i aksioneve të mbetura para emetimit shumëzohet me tre për ta fituar numrin total të aksioneve ose me dy për të fituar numrin e aksioneve shtesë.

*Shembull
Çështja e shpërblimit*

<i>Fitimi neto 2002</i>	<i>180</i>
<i>Fitimi neto 2003</i>	<i>600</i>
<i>aksionet e zakonshme të</i>	<i>200</i>

mbetura deri më 30 shtator 2003

Çështja e bonusit 1 tetor 2003 2 aksione të zakonshme për çdo aksion të mbetur më 30 shtator 2003

$$200 \times 2 = 400$$

Fitimet për aksion 2003	$\frac{600}{(200 + 400)}$	= 1,00
-------------------------	---------------------------	--------

Rikalkulimi i fitimeve të vitit paraprak për aksion me qëllime krahasimi	$\frac{180}{(200 + 400)}$	= 0,30
--	---------------------------	--------

Meqë çështja e bonusit është çështje pa konsideratë, çështja trajtohet sikur të kishye ndodhur para fillimit të 2002, periudhës më të hershme raportuese.

Ripasqyrimi

19. Nëse numri i aksioneve të zakonshme ose potenciale të mbetura e rrisin rezultatin e kapitalizimit ose çështjen e shpërblimit, kalkulimi i fitimeve për aksion për të gjitha periudhat e pasqyruara duhet të harmonizohet me të kaluarën. Nëse ndryshimet ndodhin pas datës së bilancit të gjendjes, por para botimit të raporteve financiare, kalkulimet për aksion për këto dhe çdo periudhë paraprake, raportet financiare të paraqitura duhet të jenë të bazuara në numrin e ri të aksioneve. Kur kalkulimet për aksion pasqyrojnë ndryshime të tilla në numrin e aksioneve, ky fakt duhet të shpaloset.
20. Nëse zbulohet një gabim fundamental, fitimet për aksion për të gjitha periudhat e paraqitura duhet të harmonizohen për efektet e gabimeve fundamentale konform me SKK 5 "Fitimi ose humbja neto, zërat jashtëzakonshëm, ndryshimet në vlerësimet kontabël, ndryshimet në politikat kontabël dhe gabimet fundamentale".
21. Ndërmarrja përkrahet për të shpalosur përkrahimin e transaksioneve të aksioneve të zakonshme ose transaksioneve të aksioneve të zakonshme potenciale, ndryshe nga çështjet e kapitalizimit që ndodh pas datës së bilancit të gjendjes, kur ato janë të një rëndësie të tillë mosshpalosja e të cilave do të ndikonte në aftësinë e shfrytëzuesve të raporteve financiare për t'i bërë vlerësimet dhe vendimet e duhura (shih SKK 18 "Ngjarjet pas datës së bilancit të gjendjes"). Shembujt e transaksioneve të tilla përfshijnë:
 - (a) Emetimin e aksioneve për para të gatshme;
 - (b) Emetimin e aksioneve, kur rezultatet janë përdorur për ta kthyer borxhin ose për aksionet e preferuara të mbetura në bilancin e gjendjes;

- (c) Riblerjen e aksioneve të zakonshme të mbetura.
22. Fitimet e shumave për aksion nuk harmonizohen për ato transaksione që ndodhin pas datës së bilancit të gjendjes, sepse transaksionet e tilla nuk ndikojnë në shumën e kapitalit të përdorur për ta prodhuar fitimin ose humbjen neto për periudhë.

Pasqyrimi

23. Ndërmarrja duhet ta pasqyrojë fitimin për aksion në bilancin e suksesit. Ndërmarrja duhet ta pasqyrojë fitimin për aksion me rëndësi të njëjtë për gjithë periudhën e pasqyruar.
24. Ky standard kërkon nga ndërmarrja që ta pasqyrojë fitimin për aksion qoftëse shumat që shpalosen janë negative.

Shpalosja

25. Ndërmarrja duhet t'i shpalosë këto:
- (a) Shumat e përdorura si numërues në kalkulimin e fitimit për aksion dhe pajtimin e këtyre shumave me fitimin neto ose humbjen për periudhën; dhe
 - (b) Numrin e masatares së peshuar të aksioneve të zakonshme të përdorura si emërues në kalkulimin e fitimit për aksion dhe harmonizimin e këtyre emëruesve me njëri-tjetrin.
26. Ndërmarrja mund të dëshirojë që të shpalosë më tepër informata se sa kërkon ky standard. Informata e tillë mund t'i ndihmojë shfrytëzuesit për t'i vlersuar performansat e ndërmarrjes dhe mund ta marrë formën e shumës për aksion për përbërës të ndryshëm të fitimit neto. Shpalosjet e tilla përkrahen. Prandaj, kur shumat e tilla shpalosen, emëruesit kullohen në pajtim me këtë standard në mënyrë që të sigurohet krahasueshmëria e shumave për aksion të cilat shpalosen. Nëse komponenti i fitimit neto përdoret po nuk raportohet si çështje në bilancin e suksesit, harmonizimi duhet të sigurohet ndërmjet komponentit të shfrytëzuar dhe çështjes që raportohet në bilancin e suksesit.

Data e hyrjes në fuqi

27. Ky standard hyn në fuqi për raportet financiare duke mbuluar periudhat prej ose pas 1 janar 2002.